



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.351/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.05.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Albanian Digital Printing Solution&Services” sh.p.k në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-47791-02-14-2018 me objekt “Printim faturash” me fond limit 2.929.500 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 26.02.2018 nga autoriteti kontraktor,Ujësjellës Kanalizime Shkodër.

Ankimues:

“Adel Co” shpk
Rruga “Muhamet Gjollesha”, Zogu i Zi Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a
L”3 Heronjte, Rr.3 Heronjte, Shkodër

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për

miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14.02.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-47791-02-14-2018 me objekt “Printim faturash” me fond limit 2.929.500 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 26.02.2018 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetës Kanalizime Shkodër.

II.2 . Në datën 26.02.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar Informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se më datë 01.03.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve

elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Dynamicx Group	pa ofertë	I skualifikuar
- Maksim Sulollari	pa ofertë	I skualifikuar
- ADPSS	1,715,000	I kualifikuar
- Adel Co	1,785,000	I skualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se më datë 16.03.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Dynamicx Group	pa ofertë	I skualifikuar
- Maksim Sulollari	pa ofertë	I skualifikuar
- ADPSS	1,715,000	I kualifikuar
- Adel Co	1,785,000	I kualifikuar

II.5. Në datën 07.03.2018, operatori ekonomik “Adel Co” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij dhe kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “ADPSS” shpk në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Skualifikimi i shoqërisë Adel Co shpk është bërë në kundërshtim me ligjin. Ne kemi paraqitur argumentimin e ofertës anomalisht të ulët në përputhje me nenin 56 të LPP.*
- *Së dyti kualifikimi i shoqërisë ADPSS shpk nuk ka paraqitur argumentimin e ofertës anomalisht të ulët në përputhje me LPP. Ne mendojmë se kjo shoqëri nuk ka argumentuar në përputhje me ligjin ndërtimin e ofertës ekonomike. Kjo shoqëri nuk ka paraqitur fakte apo fatura tatimore që të mbështesin këtë argument të bërë. Shpjegimi i bërë nga kjo shoqëri nuk plotëson kriteret e përcaktuara në ligj.*
- *Shoqëria ADPSS nuk disponon sistem softëare dhe hardëare sipas përcaktimit të bërë në pikën 2.3 kapaciteti teknik të operatorëve ekonomikë. Shoqëria ADPSS shpk nuk ka paraqitur faturë tatimore për blerje softi sic përcaktohet nga autoriteti juaj. Kjo shoqëri nuk ka paraqitur as faturë tvsh-je, as deklaratë zhdoganimi dhe as kontratë qeraje për sistem hardëare . Sa më sipër kërkojmë skualifikimin e këtij operatori.*

II.5. Në datën 09.03.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.1744/2 prot i ka kthyer përgjigje palës ankimuese duke vendosur pranimin pjesërisht të ankesës lidhur me kualifikimin e tij dhe mospranimin e ankesës sa i takon operatorit ekonomik ADPSS shpk.

II.6. Në datën 16.03.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.1862/1 prot., datë 27.03.2018 protokolluar me tonën me nr.523/2 datë 29.03.2018 me objekt “*Dërgohet informacion*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Gjithashtu KPP konstaton se në datën 03.04.2018 shoqëria Adel Co shpk ka dorëzuar pranë KPP shkresën nr.130 prot datë 02.04.2018 me lëndë shtesë ankese protokolluar me tonën me nr.523/3 datë 03.04.2018 në të cilën pretendon se fatura e paraqitur nga shoqëria ADPS shpk për përmbushjen e kriterit sa më sipër nuk është e rregullt pasi është e lëshuar nga një shoqëri e huaj që nuk ushtron veprimtari në RSH dhe se kjo faturë duhet të shoqërohej me me deklaratë zhdoganimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “ADPS” shpk në procedurën e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se “*kualifikimi i shoqërisë ADPS shpk nuk ka paraqitur argumentimin e ofertës anomalisht të ulët në përputhje me LPP. Ne mendojmë se kjo shoqëri nuk ka argumentuar në përputhje me ligjin ndërtimin e ofertës ekonomike. Kjo shoqëri nuk ka paraqitur fakte apo fatura tatimore që të mbështesin këtë argument të bërë. Shpjegimi i bërë nga kjo shoqëri nuk plotëson kriteret e përcaktuara në ligj*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 1862/1 prot datë 27.03.2017, rezulton se në datën 28.02.2018 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr.1661/1 prot me objekt “*kërkesë për analiza në lidhje me ofertën anomalisht të ulët*”, i ka kërkuar operatorit ekonomik “ADPSS” sqarim për ofertën ekonomike me vlerë 1,715,000 lekë. Referuar aktit të mësipërm ndër të tjera Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kërkuar sqarimet si më poshtë vijon: *Oferta juaj e paraqitur është anomalisht e ulët sepse është zbritur më shumë se 25 % e fondit limit të përlllogaritur. Me qëllim që oferta juaj të konsiderohet dhe të kualifikohet bazuar në nenin 56 të LPP kërkojmë nga ana e shoqërisë suaj të paraqesni*

detaje të mëtejshme me shkrim në lidhje me ofertën duke përfshirë elementë të cmimit dhe përllogaritjet e detajuara. Autoriteti kontraktor do të marrë në konsideratë sqarime si më poshtë:

- Aspektet ekonomike të procesit të fabrikimit/realizimit
- zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

III.1.2. Referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 1862/3 prot datë 18.05.2018, rezulton se në datën 01.03.2018 operatori ekonomik “ADPS” shpk ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor përgjigjen për kërkesën anomalisht të ulët.

III.1.2.1. Referuar shkresës së mësipërme, operatori ekonomik “ADPS” shpk ka argumentuar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon: “Kompania jonë ka filluar veprimtarinë e saj në Mars 2011 dhe objekti i veprimtarisë së saj ka qenë pikërisht Prodhimi i Faturave. Eksperienca e saj përfshin kontrata të realizuara me sukses me klientë në ndryshëm. Gjithashtu për tu përmendur që dy nga kompanitë aksionere të saj Inform Lykos Greqi (51 %) të aksioneve është një nga prodhuesit më të mëdhenj në rajon për fatura apo për produkte të tjera të zarfuara duke sjellë në ADPS praktikat më të mira ndërkombëtare në këtë fushë dhe Albdesign PSP (24.5%) të aksioneve është një nga kompanitë më të mëdha të printimit në shqipëri. Më konkretisht në lidhje me argumentimin e ofertës sonë

- aspektet ekonomike të procesit të fabrikimit/realizimit.
Duke qenë se kompania jonë ka volume të mëdha pune si dhe fakti që është pjesë e një kompanie të madhe ndërkombëtare (Inform Lykos) bën që të ketë një forcë të madhe negociuese me furnitorët nga të cilët merr cmimet më të mira për furnizimin me lëndë të para apo me shërbime të ndryshme të nevojshme për realizimin e prodhimit. Lëndët e para kryesore si letra, boja etj blihen direkt nga jashtë pa kaluar në distributorë lokalë. Duke qenë se kompania prodhon edhe për shumë klientë të tjerë bën që kostot indirekte (psh qera ambjenti, amortizim pajisjesh etj të ndahen midis shumë projektsh.
- Analiza e Detajuar e kostove është paraqitur në formë tabelare
- Zgjedhjet teknike dhe ose kushtet e jashtëzakonshme të favorizuara që janë në dispozicion të ofertuesit për ekzekutimin e shërbimeve /mallrave.
Kompania jonë ka në dispozicion tre makineri printimi industriale me ngjyra të cilat bëjnë printimin e fletëve para mbrapa në të njëjtën kohë secila me një rendiment prej 3900 fletë

A4 të printuara në dy anë në orë (ose 31.200 fletë të printuara dy anë në një turn). E vërtetuar kjo edhe me anë të kartelave teknike të këtyre makinerive të paraqitura edhe në tender. Përdorimi i letrës në rulon demonstron akoma më shumë që makineritë janë të karakterit industrial dhe jo printera të thjeshtë që janë me përdorim letre në fletë.

- Origjinalitetin e punëve /mallrave apo të shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Aktiviteti prodhues i ADPS zhvillohet në Tiranë. Të gjitha makineritë dhe pajisjet janë të instaluar në këtë adresë ku dhe zhvillohen të gjitha proceset prodhuese. Pra i gjithë cikli i prodhimit të produkteve dhe shërbimeve bëhet “inhouse” në adresën e sipërpërmendur.
- zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. Kompania zbaton me përpikmëri detyrimet që lidhen me mbrojtjen në punë e kushtet e punës si për sa i përket detyrimeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi ashtu edhe nga kriteret e kërkuara nga certifikimet ISO që disponon. Punonjësit janë të trajnuar në lidhje me aspektet e mbrojtjes në punë si dhe mbahet me përpikmëri libri i sigurimit teknik. Gjithashtu pagat deklarohen të plota, si shoqërore e shëndetësore paguhen rregullisht sipas detyrimeve ligjore. Për të vërtetuar këtë ju paraqesim listpagesat e shoqërisë sonë. Bashkëngjitur këtij dokumenti:
 1. fatura të blerjes së letrës
 2. fatura të blerjes së bojës dhe lëndëve të tjera
 3. listpagesat.

III.1.3. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...].”

III.1.4. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se “ Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni

i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni I vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]

III.1.5. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “ADPS” shpk si edhe nga përlllogaritjet e kryera Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se oferta ekonomike në vlerën prej 1,715,000 lekë pa TVSH, në zbatim të nenit 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, rezulton anomalisht e ulët. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor ka vepruar drejt kur gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave i ka kërkuar informacion të detajuar operatorit ekonomik “ADPS” shpk në zbatim të nenit 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III.1.6. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar si e tillë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të aktit normativ në zbatim të ligjit VKM 914/2014. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjen teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi, duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin si dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha

elementet e saj. K.P.P gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangjen e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët, është në disa drejtime, ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore, të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimes, K.P.P. gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin të katër kushtet kumulative të parashikuara nga neni 56 i LPP-së.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, KPP gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “ADPS” shpk në përmbushje të parashikimeve të nenit 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, janë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor përshkrime narrative si edhe dokumentacion shoqërues dhe provues mbi argumentimin ligjor, teknik dhe ekonomik të ofertës së dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, për procedurën e prokurimit objekt ankimi. Konkretisht, në lidhje me parashikimet e nenit 56 pika 1 gërma “a” të ligjit nr.9643/2006 në drejtim të argumentimit të *anës ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara*, si një prej 4 kushteve kumulative, operatori ekonomik ADPS shpk ka dorëzuar një përshkrim të detajuar të kostos në të cilën ka përshkruar kostot e lëndës së parë si letër , bojë për realizimin e shërbimit si edhe kostot ekstra si materiale kosnumi, pjesë këmbimi, asistencë teknike, kosto personeli printim fatura, amortizim pajisje printimi, energji elektrike, kosto punëtorie zarfimi selfmailer, lëndë ngjitse për zarfimin, amortizim pajisje zarfimi, kosto transporti Tiranë Shkodër, kosto të tjera indirekte administrative, provigjione. Në lidhje me parashikimet e nenit 56 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643/2006 në drejtim të argumentimit të *zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve*;, si një prej 4 kushteve kumulative, operatori ekonomik ADPS shpk ka dorëzuar fatura tatimore të blerjes së mallrave (lëndës së parë) të nevojshme për prodhimin e produktit final (letër, bojë) në të cilën deklarohen çmime për njësi. Gjithashtu, operatori ekonomik ADPS shpk ka deklaruar si kushte të veçanta për kryerjen e shërbimit edhe disponueshmërinë e fuqisë punëtore përmes paraqitjes së listëpagesave të shoqërisë si dhe tre makineri printimi industriale me ngjyra

të cilat bëjnë printimin e fletëve para mbrapa në të njëjtën kohë secila me një rendiment prej 3900 fletë A4 të printuara në dy anë në orë (ose 31.200 fletë të printuara dy anë në një turn). E vërtetuar kjo edhe me anë të kartelave teknike të këtyre makinerive të paraqitura edhe në tender. Akoma më tej, KPP konstaton se operatori ekonomik ADPS shpk njëherazi ka provuar para autoritetit kontraktor eskperiencën e tij të ngjashme. Gjithashtu janë dhënë agumentimet përkatëse lidhur me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi si dhe zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se me anë të dokumentacionit të dorëzuar ADPS shpk përmbush katër kushtet kumulative të kërkuar nga ligji i posaçëm në drejtim të argumentimit të ofertës ekonomike anomalisht të ulët. Është detyrim i operatorëve ekonomikë që në rast të shpalljes fitues t'i përmbahen zbatimit të kontratës duke ofruar shërbime/punë/mallra me të njëjtin cilësi të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe me të njëjtën ofertë ekonomike të propozuar. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penaltetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së, si më sipër cituar.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “ADPS” shpk në procedurën e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se *“Shoqëria ADPSS nuk disponon sistem software dhe hardware sipas përcaktimit të bërë në pikën 2.3 kapaciteti teknik të operatorëve ekonomikë. Shoqëria ADPSS shpk nuk ka paraqitur faturë tatimore për blerje softi sic përcaktohet nga autoriteti juaj. Kjo shoqëri nuk ka paraqitur as faturë tvsh-je, as deklaratë zhdoganimi dhe as kontratë qeraje për sistem hardëare . Sa më sipër kërkojmë skualifikimin e këtij operatori”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- ❖ *Operatori ekonomik duhet te kete e pronesi ose me qira sistem software+hardware per perpunimin e te dhenave dhe krijimin e fileve per print. Ky sistem duhet te jete ne ambjent te mbyllur dhe te dedikuar, vezhguar me kamera 24h/24. Plotesimi i ketij kriteri duhet te vertetohet me faturen tatimore te blerjes se paisjeve softëare.*

Per te vertetuar kete ,duhet te shoqerohen me dokumentat e meposhtem:

- *Kur jane ne pronesi duhet te shoqerohen me fature TVSH ose deklarate zhdoganimi*
- *Kur jane me qira, duhet te paraqitet kontrata e qirase me afat jo me te vogel se afati i zbatimit te kesaj kontrate, shoqeruar me fature TVSH ose deklarate zhdoganimi.*

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Faturë Origjinale për blerje software+hardware lëshuar nga shoqëria Inform P Lykos sa, në gjuhën angleze e përkthyer në gjuhën shqipe.*

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..*

III.2.4. Referuar kriterit të kualifikimit Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në të është kërkuar *sistem software+hardware per perpunimin e te dhenave dhe krijimin e fileve per print e cila do të provohet me anë të faturës tatimore te blerjes se paisjeve softëare. Kur jane ne pronesi duhet te shoqerohen me fature TVSH ose deklarate zhdoganimi.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “ADPS” shpk vërehet se është paraqitur një faturë origjinale blerje pajisje softi dhe hardware nga kompania greke Inform P Lykos sa e përkthyer në gjuhën shqipe.

Kjo faturë tregon se operatori ekonomik “ADPS” shpk disponon sistemin software dhe hardware të kërkuar në kriterin e kualifikimit. Pronësinë e tij e vërteton me anë të kësaj fature shitje në përputhje me kriterin e kualifikimit të përcaktuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Konkretisht në kriter është kërkuar faturë tatimore ose deklaratë zhdoganimi në formë alternative dhe jo kumulative. Në këtë kuptim KPP gjykon se pretendimi i ankimuesit se operatori ekonomik “ADPS” shpk nuk ka paraqitur faturë tatimore për blerje softi sic përcaktohet nga autoriteti juaj, nuk ka paraqitur as faturë tvsh-je, as deklaratë zhdoganimi dhe as kontratë qeraje për sistem hardware dhe software nuk rezulton të jetë i bazuar.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Akoma më tej, gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës konstatohet se ankimuesi “Adel Co” shpk ka depozituar pranë KPP shkresën nr.130 prot datë 02.04.2018 me lëndë shtesë ankese protokolluar me tonën me nr.523/3 datë 03.04.2018 me anë të së cilës pretendohet se fatura e paraqitur nga shoqëria “ADPS” shpk për përmbushjen e kriterit sa më sipër nuk është e rregullt pasi është e lëshuar nga një shoqëri e huaj që nuk ushtron veprimtari në RSH dhe se kjo faturë duhet të shoqërohej me me deklaratë zhdoganimi. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se këto pretendime janë pretendime të ngritura rishtazi të cilat nuk janë ngritur pranë autoritetit kontraktor por vetëm pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke mos ndjekur kështu shkallët e ankimit në respekt të nenit 63 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 2 dhe 7 parashikohet se: *“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji”* (pika 2) *“Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes, pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor. Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën në përputhje me këtë ligj, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme.”* (pika 7),

Neni 17 i VKM nr. 184, datë 17.03.2010, *“Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, parashikon shprehimisht se: Ankesa drejtuar Komisionit paraqitet në gjuhën shqipe në përputhje me formularin standard të ankesës sipas modelit të aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje. Komisioni publikon në faqen zyrtare formularin standard të ankesës. Ankesa duhet të përmbajë domosdoshmërisht elementet e mëposhtme: Të dhënat identifikuese të ankimuesit; Dokumentet e tenderit; Referimin për procedurën konkrete mbi të cilën paraqitet ankimi; ç) Bazën ligjore; Një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar; dh) Shkallët e ankimit shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor, nëse ka; Dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për tarifën; Pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar. Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni; kërkesën për përjashtimin e ndonjë anëtari të Komisionit për shkak të konfliktit të interesit, nëse ankimuesi ka dijeni paraprakisht për shkakun; c) kërkesën për ekspertizë të posaçme, kur kjo çmohet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.*

Operatori ekonomik ankimues, në respektim të shkallëve të ankimit, duhet të kishte ngritur të gjitha pretendimet e tij pranë autoritetit kontraktor, ashtu sikurse është përcaktuar specifikisht në ligjin e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nuk mund të shprehet mbi pretendime të cilat nuk janë bërë paraprakisht objekt ankese pranë autoritetit kontraktor dhe pa respektuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për shkak të ligjit (*ipso lege*), pretendimet e operatorit ekonomik “Adel Co” sh.p.k të cilat nuk janë ngritur fillimisht pranë autoritetit kontraktor, nuk mund të merren në shqyrtim nga KPP.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Adel Co” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-47791-02-14-2018 me objekt “Printim faturash” me fond limit 2.929.50 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 26.02.2018 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Shkodër.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 523 Protokoli, Datë 16.03.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha